



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2020:021685

Datë: 05.01.2024

Numri i dokumentit: 05158178

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit B. L. nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, të cilën e përfaqëson avokati XH. B. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson V. V., me autorizim, për çështjen kontestuese kompensim i dëmit, në seancën kryesore të mbajtur me datën 07.12.2023, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqësve, ndërsa me datën 05.01.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET, pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B. L., nga fshati ... Komuna e Kaçanikut dhe **DETYROHET**, e paditura Kompania e Sigurimeve "...", me seli në Prishtinë, që paditëses të ja kompensoj dëmin jo material dhe material, (për përgjegjësin prej 40%), të pësuar si pasojë e lëndimeve të shkaktuara, në aksidentin e komunikacionit të datës 31.12.2019 edhe atë:

I/a Dëmi jo material për:

Dhimbje trupore -fizike shumë.....840.00 €

Frikën e shkaktuar shumë660.00 €

I/b Dëmin material për:

Ndihmën dhe për kujdesin e huaj.....	40.00 €
Ushqim të përforcuar.....	168.00 €
Dëmin material në automjet në shumë prej.....	248.00€
Gjithsej shumën prej.....	1,956.00€

Të gjitha këto shuma me kamatë, prej 8%, duke filluar prej datës 07.12.2023,(data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive.

II. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë, mbi shumat e miratuar, në lartësi prej 1,618.00 €, në emër të dhimbjeve fizike, frikës, ushqim të përforcuar dhe shpenzimeve të shërimit SIE PA BAZUAR.

III. DETYROHET pala e paditur, që paditëses , t'ia paguaj shumat e gjykuara në pikën I. të këtij dispozitivi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, për përgjegjësin prej 40%, në shumë prej 918,50(1,530.00-40% = 918,50€), të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit, si në padi ashtu edhe në seancat e mbajtura, ka theksuar se më datën 31.12.2019, rreth orës 13:22 minuta, në rrugën Fusha e Pajtimit-Shtërrpcë, në fshatin ..., ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku lëndime trupore pëson paditësi B. L. nga fshati ... Komuna e Kaçanikut.

Tutje ka theksuar, se aksidenti, është shkaktuar, kur te dy njësitë, ishin duke qarkulluar në drejtim të njëjtë të lëvizjes, në rrugën Fusha e Pajtimit-Shtërpce, me të arritur në fshatin ..., në rruga A. Sh., njësia një, merre veprim të pa sigurt gjatë çkyçjes, nga rruga kryesore, ku në atë moment, mbrapa sajë vije njësia dy, e cila veç ishte në tejkalim të njësisë një dhe për shkak të bllokimit të shiritit, nga njësia një, njësia dy në pamundësi, për tu ndalur me pjesën e përparme,

të anës së djathtë, e godet njësinë një, në pjesën e anës së majtë në derën e vozitësit, duke e përfshirë shtyllën dhe mesin e anës së majtë, ku me këtë raste, përveç dëmeve materiale në të dy njësit, lëndime trupore pëson tani paditësi

Automjeti i udhëtarëve VW "...", me targë të regjistrimit ..., i cili e ka shkaktuar aksidentin, ishte i siguruar tek e paditura, por në shkaktimin e këtij aksidenti ka kontribuar edhe njësi "B", automjeti Në këtë aksident, paditësi ka pësuar lëndimi të lehtë trupor, ky fakt është vërtetuar nga ekspertiza mjekësore, ku ekspertët kanë konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të lehta trupor edhe atë: ndrydhje e regjionit të kokës, çafës dhe regjionit lumbosakral i shoqëruar me retroinstabilitet L5/S1.

Po ashtu, si rezultat i këtij aksidenti, paditësi ka pësuar dhimbje fizike, frikë, kishte nevojë për kujdesin e personit tjetër, ushqim të përforcuar dhe shpenzime materiale për shërim, fakte të vërtetuara nga ekspertiza mjekësore. Prandaj, duke i marr parasysh, këto fakte të konstatuara, ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses, të miratohet në tërësi si e bazuar si në precizimin e bërë me shkrim.

Shpenzimet i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit, si në përgjigje në padi, në seancat e mbajtura, bazën juridike të padis e ka kontestuar pjesërisht dhe ka theksuar paditësi është shkaktari kryesor i këtij aksidenti. Tutje ka theksuar se, bazuar në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit, e paditura është përgjegjëse për 20%, të përgjegjësishë. E paditura i ka kontestuar, shumat e kërkuara me precizimin e kërkesëpadisë, si shumë të larta, duke e marrë për bazë natyrën e lëndimeve dhe praktiken gjyqësore.

Tutje e ka kontestuar edhe kërkesën për kompensimin e dëmit material, në emër të ushqimit të përforcua dhe ndihmës së huajë, si shumë të larta, pasi që eksiton një praktikë gjyqësore e unifikuar që shërbimet, të cilat merren brenda familjes, të caktohet kompensimi prej 5deri në 7€, për ditët e caktuara nga eksperti.

E autorizuar e ka kontestuar, edhe kërkesën për dëmin material në veturë, për shumën prej 696,00 €, sepse e njëjta nuk është reale, sepse eksperti deri tek kjo vlerë, kishte ardhur duk mos e marrë parasysh vjetërsinë e veturës, apo amortizimin e automjetit, i cili ishte i vjetër 31

vite, në ditën kur është shkaktuar aksidenti, a dihet fakti që automjetet me kalimin e kohës e humbin vlerën. Prandaj i ka propozuar gjykatës që me rastin e vendosjes ta ketë parasysh këtë fakt.

Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës, i ka propozuar gjykatës që mos ta llogarisë seancën e datës 30.10.2023, dhe shpenzimet lidhur me precizimin e kërkesëpadisë, sepse precizimi i kërkesëpadisë, ka mundur të bëhet, në seancën e datës 30.10.2023, ndërsa sa i përket shpenzimeve tjera ta ketë për bazë suksesin e palës paditëse në procedurë.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqësve e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara: U lexuan raporti i aksidentit, raporti i policit hetues, raporti i qendrës emergjente në Ferizaj, raportet specialistike, fotot e vendit të ngjarjes, përgjigja në padi, ekspertiza e ekspertit Xh. H., sqarimi i bërë në seancë, ekspertiza e ekspertit B. L., ekspertiza e ekspertit Sh. I., sqarimet e bëra në seancë dhe mendimi i ekspertëve mjekësorë, pa vërejtje.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, gjykata me këtë çështje kontestimore juridiko- civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Aksidenti i komunikacionit, ka ndodhur më datën 31.12.2019, është shkaktuar me lëshimet me lëshimet e dy pjesëmarrëseve në aksident (njësia një automjeti VW “Golf-lëshime primare, njësia dy-automjeti BMW-lëshime sekondare). Në këtë aksident lëndim të lehta trupore ka pësuar paditësi. Si rezultat i këtyre lëndimeve paditësi, ka pësuar dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmën e personit tjetër, ushqim të përforcuar, fakte këto, të cilat sipas nenit 136, 159 dhe nenit 169 të LMD-ës, paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

a) Se aksidenti, ka ndodhur me datën 31.12.2019, rreth orës 13:22 minuta, në rrugën Fusha e Pajtimit-Shtërpce, në fshatin ..., këtë fakt gjykata e vërtetoi nga Raporti i aksidentit dhe Raporti i policit hetuesi i datës 31.12.2019, por ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

b) Se aksidenti i datës 31.12.2019, është shkaktuar, me lëshimet e dy pjesëmarrësve në aksident, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit B. L. . Ky ekspertët, ka konstatuar, se deri tek aksidenti, ka ardhur me lëshimet e dy pjesëmarrësve në komunikacion edhe atë: lëshimet primare nga ana e shoferit të automjetit “A “ (VW-Golf), me targ të regjistrimit ..., për shkak të çkyçjes së pa sigurte në të majtë nga rruga kryesore në rrugën dytësore dhe pengimin i automjetit B, gjatë fazës së tejkalimit. Ndërsa lëshimet sekondare në këtë aksident ka pasur edhe shoferi i automjetit “B”(BMW), me targë të regjistrimit ..., i cili para ndërmarrjes së veprimit për tejkalim të automjetit “A “ (VW-Golf), nuk e kishte vlerësuar drejtë situatën në komunikacion par mjetit të tij, në momentin kur automjeti para tij kishte zvogëluar shpejtësinë me qëllim të ndërmarrjes së veprimit për kthim majtas.

Se në këtë aksident, paditësi B. L. , ka pësuar lëndim të lehtë trupor, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga ekspertiza e mjekësorëve mjekësorë, të cilët kanë konstatuar se paditësi ka pësuar: ndrydhje e regjionit të kokës, regjionit të çafës regjionit lumbosakral, i shoqëruar me retroinstabilitet L5/S1. Si pasojë e këtij lëndimi, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike, frikë, ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tret, ushqim të përforcuar, rehabilitim si dhe ka pasur shpenzime për shërim, ka pësuar damë material në automjete, fakte të cilat paraqesin bazë për kompensim.

Nga mendimi i mjekësorëve mjekësorë, është konstatuar se paditësi, si rezultat i këtij aksidenti, ka përjetuar dhimbje fizike, të intensitetit posaçërisht të rëndë, që kanë zgjatur 20 minuta (koha nga momenti i fatkeqësisë, transportit, procedura e diagnostikimit, e deri në fillimin e mjekimit). Dhimbje të intensitetit të rëndë, që kanë zgjatur 3 ditë, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve. Dhimbje të intensitetit të mesëm, që kanë zgjatur për 15 ditë, dhimbje të kohë pas kohëshme, për shkak të e demës së indeve të buta dhe aparatit ligamentar, spazmës muskulare, koha e nevojshme, për tërheqjen nën veprimin e terapisë. Pastaj këto dhimbje kanë kaluar në dhimbje të intensitetit më të ulët, sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin ai ende ankohet për dhimbje, të cilat dhimbje janë më të shprehura gjatë ndryshimeve klimaterike, qëndrimeve më të gjata në këmbë dhe bartjen e peshave të rënda, këto janë fakte të cilat paraqesin bazë për kompensimin e dëmit.

Prandaj gjykata duke pas parasysh llojin e lëndimeve, vendin e lëndimit, moshën e paditëses, vështirësitë dhe situatat e pa-lakmueshme, të cilat e kanë përcjelle gjatë mjekimit,

shqetësimet që ndodhin gjatë trajtimit mjekësor, kontributin në shkaktimin e aksidentit, e ka caktuar shumën prej 840€, e cila do të shërbej si satisfakcion për dhimbjet e pësuar.

Nga mendimi i ekspertës së psikiatrisë Dr. N. M. -Psikiatër, e cila ka konstatuar se paditësi ka pësuar frikë primare, e cila ka zgjatur disa sekonda në momentin e aksidentit, koha brenda së cilës paditësi ka përjetuar ndjenjën e përfundimit fatal-frikë nga vdekja. Pastaj kjo frikë, ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të lartë, që kanë zgjatur 2 ditë, e shoqëruar me reagimit akute ndaj stresit, të përjetuar pas traumës fizike, ankthe gjatë natës, çrregullim i gjumit, frik nga invaliditeti i përhershëm dhe pasojave të lëndimit. Pastaj kjo frikë ka kaluar në frikë sekondare të intimitetit të mesëm, e cila ka zgjatur 1 muaj, e shoqëruar me çrregullime gjumi, ankthe me rikujtim të herë pas hershëm të ngjarjes traumatikë, vështirësi të adoptimit me kushtet e i mobilizimit mjekësor, me qafore ortopedike dhe korzet, nervozë me brengë për ecurinë e mjekimit, indisopnimit dhe labilitetit emocional.

Pastaj kjo rikë ka kaluar në frikë të intensitetit të ulët, e cila ka zgjatur 3 muaj, e shoqëruar me vështirësi të adoptimit në periudhën e rehabilitimit, nervozë, shqetësime të herë pas hershme gjatë gjumit, rënjës së dispononit, sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Fakte këto të cilat paraqesin bazë për kompensim të dëmit. Prandaj gjykata duke pas parasysh kohëzgjatjen dhe intensitetin e frikës së pësuar, intensitetin e frikës, e cila është ekuivalente me lëndimet e marra trupore, llojin e lëndimit, moshën e paditësit, vendin e lëndimit, kontributin në shkaktimin e aksidentit, e ka caktuar shumën prej 660,00 €.

Nga mendimi i ekspertëve, është konstatuar, se paditësi ka pasur nevojë, për ndihmën e personit tjetër, në kohëzgjatje prej 10 ditë. Kjo ndihmë konsiston për kryerjen e disa aktiviteteve të përditshme jetësore, siç janë, ushqimi, veshmbathja, hixhenës dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor, e cila ndihmë është ofruar nga familjarët. Prandaj gjykata duke pasur parasysh nevojën e sajë për ndihmën e personit të tretë, praktikën gjyqësore dhe kontributin në shkaktimin e aksidentit, ka gjykuar shumën prej 168.00€, e cila shumë është adekuate dhe përkon me kriteret e kompanive, praktikë gjyqësore dhe koha e nevojshme për ndihmën e personit tjetër., .

Nga mendimi i grupit të ekspertëve, është konstatuar se paditëses, ju është nevojitur ushqimi i përforcuar për 4 javë, i pasur me proteina, albumina, karbohidrate, vitamina dhe minerale. Prandaj gjykata duke e pasur parasysh nevojën e tij për ushqim të përforcuar, praktikën gjyqësore për këto raste dhe kontributin e paditësit, e ka gjykuar shumën prej 40.00€,

e cila shumë është adekuate dhe përkon me shpenzimet reale, që paditësja i ka pasur për marrjen e ushqimit të përforcuar gjatë periudhës së shërimit.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, raportit të aksidentit, raportit të policit hetues të datës 31.12.2019, përgjigjes në padi, ekspertizës mjekësore, theksimeve të palëve ndërgjyqës, të bëra gjatë këtij procesi gjyqësor, ekspertizë së ekspertit të komunikacionit B. L. , kërkesëpadinë e paditëses, e miratoi pjesërisht si të bazuar, sepse edhe paditësi ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti.

Është vërtetuar se lëshimet primare janë nga ana e shoferit të automjetit “A “ (VW-Golf), me targë të regjistrimit ..., për shkak të çkycjes së pa sigurte në të majtë nga rruga kryesore në rrugën dytësore dhe pengimin i automjetit B, gjatë fazës së tejkalimit. Ndërsa lëshimet sekondare, në këtë aksident, ka pasur edhe shoferi i automjetit “B”(BMW), me targë të regjistrimit ..., i cili para ndërmarrjes së veprimit për tejkalim të automjetit “A “ (VW-Golf), nuk e kishte vlerësuar drejtë situatën në komunikacion par mjetit të tije, në momentin kur automjeti para tij, kishte zvogëluar shpejtësinë me qëllim të ndërmarrjes së veprimit për kthim,

Nga ekspertiza mjekësore, është konstatuar se paditësi, ka pësuar lëndime të lehtë trupor ,me fajin e të siguruarit të paditurës- lëshimet sekondare dhe me fajin e të paditurit-lëshimet primare, e ky fakt nuk ishte kontestues në mesë të palëve ndërgjyqëse. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë, këto fakte të shënuara më lart, ka ardhur në përfundim se kompensimi i gjykuar si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi është i drejtë dhe real dhe në harmoni me kontributin dhe praktikën gjyqësore. Po ashtu është në harmoni me udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Gj.A 41/2023, i datës 27.02.2023.

Nga sa u theksua më lart, u vërtetua se paditësi, si pasoj e lëndimeve të shkaktuara, në aksidentin e cekur më lart, ka pësuar dëm material dhe jo material në shumat e caktuara dhe përgjegjësinë për këtë dëm në rastin konkret e mban e paditura, dhe i padituri, nga baza e auto përgjegjësi. Prandaj gjykata, konform dispozitave të neneve 136, 159, dhe 169, të LMD-së, me këtë gjendje të vërtetuar faktike e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia kompensojë dëmin e pësuar në shumat e gjykuara sipas të gjitha bazave të pranuar.

Me dispozitën e nenit 136 par.1 të LMD-së është paraparë se kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensojë përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij,

nga provat në shkresat e lëndës, është vërtetuar se dëmi është shkaktuar me fajin e të siguarit të të paditurës, e në rastin konkret është vërtetuar se edhe i padituri ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti (lëshimet primare të paditurit – fakt i vërtetuar me ekspertizën e ekspertit të komunikacionit).

Me dispozitën e nenit 159 të LMD-së, është paraparë, se në rast të aksidentit të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje, që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi, zbatohen rregullat për përgjegjësinë në baze të fajit. Me nenin 169 të LMD-së, është paraparë, se personi përgjegjës, ka për detyrë ta rivendos gjendjen, e cila ka qene para se të shkaktohet dëmi, ndërsa në paragrafin 2, është paraparë në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të ja shpërblen në të holla.

Prandaj gjykata duke u bazuar në konstatimet e shënuara më lartë të ekspertëve, e duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, në vlerësimin e lirë ka ardhur në përfundim se shumata e gjykuara në dispozitiv të këtij aktgjykimi, janë shuma reale dhe në përpjesëtim me dëmin e pësuar nga paditësja për shkak të dhimbjeve të përjetuara fizike, frikë, ushqim të përforcuar, ndihmës së personit të tretë, prandaj për të gjitha këto e caktoi kompensimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me propozimin e palëve ndërgjyqës, nuk i ka dëgjuar ekspertet mjekësorë, sepse edhe pala paditëse edhe pala e paditur, nuk e kanë kontestuar ekspertizën mjekësorë dhe i kanë propozuar gjykatës që të mos dëgjohen ekspertët mjekësorë. Prandaj gjykata duke pasur parasysh këto kërkesa të palëve ndërgjyqëse ka vepruar konform nenit 368 të LPK-së, ku është paraparë se seanca për shqyrtim kryesor mbahet edhe po që se eksperti nuk vjen në të, sepse palët kanë propozuar që të mos dëgjohen ekspertet sepse nuk kishin vërejtje as pyetje për ekspertët mjekësorë.

Gjykata e refuzoi, një pjesë të kërkesëpadisë së paditëses, mbi shumën e gjykuar në lartësi prej 1,618,00 €, për dhimbje fizike, frikë ushqim të përforcuar, ndihmën e personit të tretë, sepse paditësi ka kontribuar në shkaktimin e këtyre lëndimeve, gjykata po ashtu e refuzoi edhe kërkesën sa i përket shpenzimeve të shërimit, sepse pala paditëse nuk ka prezantuar prova për ta vërtetuar këtë fakt.

Meqenëse pala e paditur ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit. Gjykata me kërkesën e palës paditëse dhe në bazë të nen.382 të LMD-së, e detyroi të paditurën që paditësit në shumat e gjetuara t'ia paguaj edhe kamatën vjetore prej 8% edhe atë duke filluar nga data 07.12.2023(data e seancës kryesore), e deri në pagesën definitive.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila i propozoj gjykatës që kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar. Këto pretendime gjykata i analizoi dhe ua dha pjesërisht besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Paditësi këtë dëm e ka pësuar me lëshimet primare të paditësit dhe lëshimet sekondare të të siguarit të paditurës, fakt i sqaruar më lartë.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të autorizuarit të paditurës, i cili i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratojë pjesërisht si të bazuar, edhe atë vetëm për përgjegjësin prej 20% , të përgjegjësisë. Por këtyre theksimeve gjykata u a fali pjesërisht besimin, sepse mendon se në rastin konkret kanë përgjegjësi të ndarë edhe atë paditësi ka kontribuar me 60%, në shkaktimin e këtij aksidenti, ndërsa i siguarit i të paditurës ka kontribuar me 40 %, të përgjegjësisë ,këtë ndarje e ka bërë duke u bazuar në ekspertizën e ekspertit të komunikacionit, i cili në mendimin dhe konstatimin e tij, në mënyrë detale ka dhen sqarime për kontributin e pjesëmarrësve në komunikacion.

Gjykata e detyroi palën e paditur, që paditësit të ja paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, për përgjegjësin prej 40%, në shumë prej 918, 50€ (1,530.00-40% = 918,50€), edhe atë: 104,00 €, për përpilimin e padisë, 200,00€, për ekspertizën e komunikacionit, 150,00€, për ekspertizën e ekspertit të makinerisë, 200,00€, për ekspertizë mjekësori, 104,00€, për precizimin e kërkesëpadisë, shumë prej 742,00€, për 5 seanca të mbajtura dhe një të shtyre dhe 30,00€, në emër të taksës për padi(të parapara sipas udhëzimit administrativ nr.01/2017 të Këshillit Gjyqësorë), gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1, të LPK-së.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C .nr.58/2020 prej datës 07.12.2023

Gjyqtari:
Riza Livoreka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.